



## Përditësim

Mirë se vini në informimin javor të Dhomave të Specializuara të Kosovës, ku synojmë t'u ofrojmë gazetarëve informacion të përditësuar mbi zhvillimet më të fundit në Gjykatë dhe mundësinë për të bërë pyetje.

Të hënën, më 17 prill, Trupi Gjykes urdhëroi vazhdimin e paraburgimit të z. Thaçi and z. Veseli. Trupi Gjykes konstatoi se vazhdon të ekzistojë rreziku që z. Thaçi and z. Veseli të pengojnë ecurinë e procesit dhe/ose të kryejnë vepra penale të tjera. Trupi Gjykes konstatoi gjithashtu se këto rreziqe mund të zvogëlohen mjaftueshëm përmes kornizës për monitorimin e komunikimeve që përdoret në objektin e paraburgimit të DHSK-së. Duke qenë se si z. Thaçi ashtu dhe z. Veseli, kanë qëndruar në paraburgim për një periudhë kohe të konsiderueshme, Trupit Gjykes dhe palëve u kërkohet të mbajnë parasysh nevojën që gjykimi të kryhet sa më shpejt që është e mundshme.

Dy dëshmitarët e parë të thirrur nga Prokuroria në gjykimin e Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Jakup Krasniqit dhe Rexhep Selimit i përfunduan dëshmitë e tyre. Ata dëshmuan me masa mbrojtëse dhe kryesisht në seancë private dhe që të dyve iu bënë pyetje nga ekipet e Mbrojtjes, dhe njërit prej tyre edhe nga mbrojtësi i viktimave. Dëshmia e dëshmitarit të tretë po vazhdon dhe po kryhet në seancë të mbyllur.

Të gjitha gjykimet në DHSK janë publike; megjithatë ndonjëherë gjykatësit vendosin të kryejnë një pjesë të seancës në atë që quhet seancë private, ose të redaktojnë informacione të caktuara për të mbrojtur identitetin dhe sigurinë e dëshmitarëve ose viktimave.

Vendimi për ta kryer seancën në seancë private për të mbrojtur dëshmitarët shqyrtohet me shumë kujdes nga gjykatësit, rast pas rasti. Edhe kur dëshmia e dëshmitarit nuk është publike, avokatët e të akuzuarve e dëgjojnë atë që thotë dëshmitari dhe kanë të drejtën t'i bëjnë pyetje.

Seanca e sotme në gjykimin *Thaçi dhe të tjerë* është paraparë të përfundojë në orën 16:00. Paraqitja e provave nga Zyra e Prokurorit të Specializuar do të vazhdojë të mërkurën, më 10 maj, në orën 9:00 të mëngjesit.

Në çështjen gjyqësore *Pjetër Shala*, më 13 prill, Trupi Gjykes autorizoi dhënien e dëshmisë nga tre dëshmitarë përmes videolidhjes. Trupi Gjykes konstatoi se teknologjia ekzistuese mundëson që dëshmitarët të pyeten me të njëjtat kushte si në sallën e gjyqit dhe do t'u mundësojë këtyre dëshmitarëve që të dëshmojnë pa ankth, çka do të përmirësojë cilësinë e dëshmisë së tyre dhe do të jetë në të mirë të mirëqenies së tyre fizike dhe psikologjike. Rrjedhimisht, Trupi Gjykes urdhëroi Zyrën Administrative të bëjë përgatitjet e nevojshme për të siguruar respektimin e masave mbrojtëse për dëshmitarët.

Në të njëjtën çështje gjyqësore, më 14 prill, ZPS-ja dorëzoi versionin publik të redaktuar të dosjes paraprake të saj, në zbatim të urdhrin të Trupit Gjykes.





Seanca vijuese në këtë çështje gjyqësore është caktuar të fillojë të hënën, më 1 maj, në orën 9:30. Seancat e gjykimit në këtë çështje do të vazhdojnë gjatë gjithë javës, nga 1 deri në 5 maj.

Në lajme të tjera, këtë javë ekipi për komunikim dhe ndërgjegjësim i DHSK-së u takua me përfaqësues të shoqërisë civile në Graçanicë dhe me nxënës të shkollës së mesme në Gjakovë. Gjatë këtyre takimeve, përfaqësuesit e DHSK-së shpjeguan mandatin dhe procedurat e Gjykatës, si dhe iu përgjigjën pyetjeve.

### **Pyetje nga gazetarët**

